



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



**2015**

Bankat për Shoqërinë

Raport CSR

SË BASHKU PËR  
NJERËZIT  
SHOQËRINË  
MJEDISIN  
JETËN

BANKAT PËR SHOQËRINË



ALPHA BANK



abi  
AMERICAN BANK  
OF INVESTMENTS



BKT  
BANKA KOMBËTARE TREGTARE



CREDINS bank



CBA  
CREDIT BANK OF ALBANIA  
BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRIE



Fibank  
First Investment Bank



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK  
rëndësi kanë vlerat



INTESA SANPAOLO BANK  
Albania



NBG Bank



ProCredit Bank



Raiffeisen  
BANK



SOCIETE GENERALE  
ALBANIA



TIRANA  
BANK



UNIONBANK



UBA  
Banka e Bashkuar  
e Shoqërisë  
United Bank  
of Albania



VENETO BANKA  
GRUPPO VENETO BANCA

# PARATHËNIE

Shoqata Shqiptare e Bankave, për të dytin vit radhazi, boton raportin vjetor të Përgjegjësisë Sociale Korporative, si një risi në treg dhe në rugën e vet të krijimit të traditës.

Përgjegjësia Sociale Korporative (PSK ose CSR në anglisht) si një mekanizëm vet rregullues i integruar në modelin e biznesit, i jep mundësi biznesit të monitorojë dhe sigurohet që veprimtaria e tij kryhet në përputhje me frymën e ligjit, me standardet etike dhe me normat kombëtare e ndërkombëtare. Përkufizimi i PSK nënkupton që çdo biznes të konsiderojë ndikimin shoqëror dhe atë ambiental të biznesit të tij tek shoqëria në përgjithësi dhe të synojë të reagojë në mënyrë të përgjegjshme, të balancuar dhe vullnetare ndaj interesave të të gjitha palëve të interesuara.

Përgjegjësia ndaj ambientit dhe mirëqenies sociale është rritur nga një dekadë në tjetrën. Nga vitet '60, kur filloi të flitet për herë të parë për PSK, ajo ka gjetur përkrahje më të gjerë nga aktorët për zbatim dhe nga institucione ndërkombëtare për mbështetje. Komisioni Evropian në vitin 2011 vendos theksin te "përgjegjësi e ndërmarrjeve për ndikimin e tyre në shoqëri". PSK është bërë e rëndësishme për bizneset që kur ajo u mundësoi shoqërive tregtare, njëkohësisht, të drejtojnë bizneset e tyre në një mënyrë që është me përfitim për shoqërinë në përgjithësi dhe për të nxitur sukses afatgjatë dhe fitimprurës. Kështu, në vend të pikëpamjeve tradicionale rreth konkurrencës, mbijetesës dhe fitueshmërisë, sot bizneset nxiten drejt PSK nga ngushtimi i rolit të qeverisë, kërkesat për transparencë më të madhe, rritja e interesit të klientit, rritja e presionit të investitorëve, konkurrenca e tregut të punës dhe marrëdhëniet me furnizuesit.

PSK sot nuk është më vetëm një veprim filantropik i korporatës. Ky mund të jetë një dimension i trashëguar dhe tradicional, por jo më domethënës. Nga korporatat kërkohet të bëjnë biznes të përgjegjshëm dhe të kontribuojnë me investime, inovacione dhe bashkëpunim një zhvillim të qëndrueshëm, që kanë ndikim në ambient dhe në mirëqenien e shoqërisë.

Nga natyra e tyre, bankat, si institucione financiare, drejtojnë progresin ekonomik dhe atë shoqëror. Ato sigurojnë financime që ndihmojnë rritjen e ekonomisë dhe të bizneseve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkufitar duke drejtuar në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Përtej kësaj, mbështetja e tyre financiare dhe jofinanciare në shumë fusha të ndryshme, duke përfshirë kujdesin ndaj komunitetit, arsimin, sportin, artin



dhe shumë fusha të tjera, plotëson rolin e shtetit dhe të organizatave joqeveritare.

Ky botim përpiqet që, për herë të parë, të paraqesë veprimtaritë e bankave në kuadrin e PSK-së sipas 17 Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të miratuara në vitin 2015 nga Kombet e Bashkuara, në 14 prej të cilave janë klasifikuar veprimtaritë sociale të zhvilluara nga bankat, edhe pse Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Kombet e Bashkuara u adoptua në shtator 2015. Në mbështetje të këtij programi, raporti aktual synon të frymëzojë aktivitete të ardhshme të PSK duke ilustruar se si iniciativat vullnetare në kuadër të PSK i kanë shërbyer zhvillimit të qëndrueshëm, shoqërisë dhe palëve të interesuara. Sektori bankar mbetet i angazhuar për të përdorur praktikat më të mira në bashkëpunimin me palët e interesuara. Vetëm gjatë vitit 2015, bankat kanë financuar mbi 1.1 milionë euro për aktivitetet me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rreth 200 mijë euro për sponsorizime në art, kulturë dhe sport.

Shoqata Shqiptare e Bankave mbetet një mbështetëse e fortë e kontributit që bankat duhet të japin në shoqëri dhe e angazhuar për të demonstruar që ky kontribut për rritje të qëndrueshme dhe përfshirëse është i efektshëm dhe i përshtatshëm.

**Spiro Brumbulli**

*Spiro Brumbulli*

Sekretar i Përgjithshëm  
Shoqata Shqiptare e Bankave

## Të nderuar anëtarë të Shoqatës Shqiptare të Bankave,

Në fund të shtatorit të vitit të kaluar, u shënua një arritje e madhe: Miratimi i “Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm” në Samitin e Kombeve të Bashkuara, të zhvilluar në New York. Agjenda e re përmban një sërë objektivash dhe qëllimesh universale, transformuese dhe të integruara, të quajtur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Ato synojnë nxitjen e një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, mbrojtjen sociale dhe një mjedis të shëndetshëm.

Kam kënaqësinë të shkruaj këtë mesazh në raportin tuaj për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës. Një agjendë e suksesshme për zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri kërkon partneritet ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ky raport thekson kontributin e përpjekjeve tuaja të Përgjegjësisë Sociale Korporative në këtë drejtim. Kompanitë në mbarë botën, gjithnjë e më tepër ndiejnë nevojën për të bërë biznes në mënyrë të përgjegjshme dhe janë në kërkim të mundësive për zgjidhjen e sfidave globale nëpërmjet inovacionit, investimeve dhe bashkëpunimit. Në të njëjtën kohë, zbatimi i suksesshëm i OZHQ-ve, do të forcojë mjedisin për të bërë biznes.

Kombet e Bashkuara, nëpërmjet zhvillimit të Kuadrit të ri të Asistencës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara 2017-2021, janë të angazhuar për të ndihmuar Shqipërinë në arritjen e qëllimeve të reja. Ne punojmë me qeverinë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Partneriteti ynë shtrihet me shoqërinë civile, dhe gjithnjë e më shumë me sektorin privat, për të trajtuar çështje të tilla si pabarazia, padrejtësia dhe ndryshimet klimatike. Motoja jonë është që askush të mos lihet prapa.

Shqipëria ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në formulimin e OZHQ-ve, duke dhënë opinionet e qytetarëve të saj gjatë fushatave “Zërat e Shqipërisë” dhe “E ardhmja që duam”. Gjithashtu, Shqipëria ka qenë vullnetare për pilotimin e zbatimit të Objektivit 16: paqe, drejtësi dhe institucione të forta. Qeverisja e mirë, siç e dimë të gjithë, është një komponent thelbësor për arritjen e të gjitha OZHQ-të e tjera.



Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-moon, tashmë është koha për veprim. Ne kemi pesëmbëdhjetë vjet për të arritur këto objektiva, dhe ora po troket. Gjate viteve të fundit Shqipëria, ka shënuar përparim të dukshëm në rrugën e saj drejt integritit evropian, me reforma ambicioze dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë, sfidat mbesin dhe planet ambicioze -si ai i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm – kërkojnë që zbatimi të jetë kuptimplotë.

Raporti ofron një panoramë të gjere se si sektori privat promovon agjendën e përfshirjes sociale. Janë frymëzues shembujt që lidhen me veprime konkrete për të mbështetur njerëzit me sindromën Down dhe autizëm, përpjekjet e bankave për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, mënyra se si zhvillohen shërbime të reja rreth efikasitetit të energjisë, dhe se si vetë punonjësit e bankës janë të përfshirë në mënyrë aktive në mësimdhënie dhe aktivitete për ruajtjen e mjediseve të përbashkëta, të cilat janë vetëm disa shembuj për t'u përmendur. Shoqata Shqiptare e Bankave është e para për sa i përket përfshirjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në biznes dhe unë shpresoj se ju do të mund të frymëzoni shoqata dhe organizata të tjera.

**Brian Williams**

Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri  
Kombet e Bashkuara në Shqipëri

## Përmbajtja

<b>OBJEKTIVI 1</b>	- Pa Varfëri .....	6
<b>OBJEKTIVI 2</b>	- Zero Uri.....	8
<b>OBJEKTIVI 3</b>	- Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie.....	10
<b>OBJEKTIVI 4</b>	- Arsim Cilësor .....	12
<b>OBJEKTIVI 5</b>	- Barazi Gjinore .....	14
<b>OBJEKTIVI 6</b>	- Ujë i Pastër dhe Kanalizime .....	15
<b>OBJEKTIVI 7</b>	- Energji e Përbalueshme .....	16
<b>OBJEKTIVI 8</b>	- Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike.....	18
<b>OBJEKTIVI 9</b>	- Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë.....	20
<b>OBJEKTIVI 10</b>	- Zvogëlim i Pabarazive .....	22
<b>OBJEKTIVI 11</b>	- Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme.....	24
<b>OBJEKTIVI 12</b>	- Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm.....	26
<b>OBJEKTIVI 13</b>	- Veprim për Klimën .....	28
<b>OBJEKTIVI 17</b>	- Partneritet për Objektivat.....	30
Veprimtari të Veçanta .....		33
Art, Sport dhe Kulturë .....		34
Çmime.....		36

## OBJEKTIVI #1 – Pa varfëri

### Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo<sup>1</sup>

- > Të zhduket varfëria ekstreme për të gjithë njerëzimin, anembanë globit. Aktualisht varfëria ekstreme matet si “njerëz që jetojnë me më pak se 1.25 \$ në ditë”.
- > Të paktën të përgjysmohet raporti i burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj, sipas përcaktimeve kombëtare.
- > Të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfërit dhe më të dobët, të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe mundësi për shërbimet themelore, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe format e tjera të pronësisë, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologjisë më të re të përshtatshme dhe në shërbimet financiare duke përfshirë mikrofinancat.



**YES BANK** ka zbatuar parimin udhëzues të Inovacionit për Kursim për Përfshirjen Financiare (FI4FI) në teknologjinë mbështetëse sistematike dhe modele të biznesit të kujdesshëm, për të ofruar mikro kredi të drejtpërdrejta, kursime mikro, sigurime mikro dhe të shërbimeve të dërgesave në kontekste të ndryshme gjeografike dhe socio-ekonomike, për popullsinë klientë dhe joklientë banke në Indi. Për shembull, Yes Bank lançoi “YES Kisan Dairy Plus” një paketë të plotë të produkteve financiare për sektorin e bulmetrave përmes një makine automatike testimi qumështi, e instaluar në baxhot partnere, të cilat mund të japin informacion të menjëhershëm në cilësinë dhe sasinë e qumështit të furnizuar nga fermeri i vogël i qumështit. Fermeri mund të paguhet menjëherë përmes “YES Kisan Bulmet Plus” në llogarinë e tij të kursimit.

**Burimi: UN Global Compact & Business për vitin 2030**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 1. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



*Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo*

Kontributi i sistemit bankar përgjatë vitit:  
mbi 75,000 euro.

## Projekte - Përfshirje Publike

### FIBANK ALBANIA

- Dhurime në veshje dhe lodra, për plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të fëmijëve jetimë në Shkodër.
- Dhënia e mbështetjes për fëmijët e Fshatit SOS, nëpërmjet dhurimit të një fondi të veçantë.

### INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK (ICB)

Donacion për fëmijët e Fshatit SOS ku banka, për të katërtin vit radhazi, vazhdoi të plotësojë nevojat për dy nga fëmijët e këtij fshati.

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Ndërmori me vetëdijen e punonjësve të saj disa nisma të cilat kanë të bëjnë me dhurata bamirëse, të tilla si: në të holla për personat me aftësi të kufizuara, Kryqin e Kuq Shqiptar, të moshuarit dhe familjet në vështirësi sociale.

### NBG BANK ALBANIA

Gjatë festave të fundvitit Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizoi veprimtari festive në 28 qendrat e kujdesit social në Shqipëri. Banka dhuroi fonde në mbështetje të qendrave të qytetit të Vlorës dhe Sarandës.

### RAIFFEISEN BANK

- Me rastin e festave të fundvitit, nën moton: “Surprizë në një kuti”, punonjësit e bankës dhuruan dhe shpërndanë 300 dhurata për fëmijët e zonës së Kombinatit.
- Nëpërmjet “H. Stepic CEE Charity” mbështeti Qendrën “Don Bosko” në Tiranë me projektin për mbështetjen e fëmijëve të rrugës dhe familjeve e tyre në Tiranë.

### TIRANA BANK

- Sponsorizimi i jetesës së tre fëmijëve nga Fshati SOS, një bashkëpunim afatgjatë, që mundëson mbështetje për një kujdes të individualizuar dhe promovimin e zhvillimit dhe arsimimit për këta fëmijë.
- Dhuratat për festat e fundvitit për familjet në nevojë në Zall-Herr, një bashkëpunim ky me Bashkinë e Tiranës.
- Mbështeti zonat e prekura nga përmytjet.



## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### NBG BANK ALBANIA

Mbështeti veprimtarinë e organizuar në 13 janar nga Ambasada Austriake dhe Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, nëpërmjet blerjes së biletave për stafin e saj, me qëllim mbledhjen e fondeve për Fshatin SOS në Tiranë.

## Biznesi Bazë Produkte dhe Shërbime

### CREDINS BANK

Mbështeti mikro bizneset dhe agrobizneset me produkte dhe shërbime të përshtatura për to, me qëllim që t'i shërbejë më mirë dhe për ta zhvilluar këtë segment.

## OBJEKTIVI #2 – Zero uri

### Arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme <sup>1</sup>

- > Deri në vitin 2030, t'i jepet fund urisë dhe të sigurohet qasje për të gjithë njerëzit, në veçanti të varfërve dhe njerëzve në situata të cënueshme, duke përfshirë foshnjat, me ushqim të sigurtë, të shëndetshëm dhe të mjaftueshëm, përgjatë gjithë vitit.
- > Të dyfishohet produktiviteti bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve të vegjël të produkteve ushqimore. Veçanërisht gratë, popujt indigjenë, fermerët familjarë, blegtorët dhe peshkatarët të kenë të drejta të sigurta dhe të barabarta për tokën, burimet e tjera prodhuese dhe ushqimin, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë me vlerë të shtuar si dhe punësimin jashtë sektorit të bujqësisë



**Sompo Japan Nipponkoa Holdings, Inc.** ofron sigurimin e produkteve bujqësore në Azinë Juglindore, për të zvogëluar klimën e rrezikut që lidhet me bujqësinë. Ajo lançoi sigurimin e treguesve të motit në verilindje të Tajlandës në vitin 2010, për të lehtësuar humbjet e fermerëve të orizit, kur prodhimet e tyre dëmtohen nga thatësira ndërkohë që hapësira e shitjes së këtij sigurimi po zgjerohet çdo vit.

**Burimi: UN Global Compact & Business për vitin 2030**

### Projekte - Përfshirje Publike

#### ALPHA BANK ALBANIA

Stafi dhuroi pako ushqimore në një qendër humanitare të quajtur “Supa e dashurisë”. Kjo qendër është krijuar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe shërben ushqim çdo ditë për më shumë se 150 njerëz të cilët nuk mund të përballojnë shpenzimet për të blerë ushqime.

#### CREDINS BANK

Bashkëpunoi me grupe bamirësie/organizata të përkushtuara për kujdesin e jetimëve dhe fëmijët e braktisur dhe ka mbështetur projekte të ndryshme për të ndihmuar në luftën kundër varfërisë, të tilla si: Fshati i Fëmijëve SOS, Kryqin e Kuq Shqiptar, Qendrën Sociale “Don Bosko”, I.E.C.D. në Berat dhe Fondacionim “Fëmijët Shqiptarë”.

#### FIBANK ALBANIA

Bashkëpunoi me “Qendrën Ditore të Zhvillimit”, për fëmijë/të rinj me aftësi të kufizuara në qytetin e Korçës. Fibank, me blerjen e pikturave të bëra nga vetë fëmijët, i përdori ato si dhurata për festa.

<sup>1</sup> Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 2. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.





## Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme

Kontributi i sistemit bankar gjatë vitit: mbi 42,000 euro. Stafi ka dedikuar 90 orë shtesë pune për projekte.

### INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK (ICB)

Gjatë fundvitit, punonjësit e bankës financuan vullnetarisht blerjen e ushqimit të nevojshëm për një nga familjet në Fshatin SOS. Gjithashtu, banka sponsorizoi kartolinat e fundvitit, duke shfrytëzuar dhe blerë vizatimet e fëmijëve të Fshatit SOS në Shqipëri.

### RAIFFEISEN BANK

Dhuroi pajisje elektroshtëpiake për familjet e prekura nga përmbytjet në pjesën jugore të Shqipërisë (zona Fier).



### Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### Biznesi Bazë Produkte dhe Shërbime

#### NBG BANK ALBANIA

Mbështeti festimet e Ditës së Fëmijëve, duke dhuruar dhurata për 100 fëmijë jetimë.

#### SOCIETE GENERALE ALBANIA

• Banka sponsorizoi një pjesë të veprimtarisë: “Dita e Donatorëve”, të organizuar në datën 21 maj nga Fshati i Fëmijëve SOS në Shqipëri, si dhe ishte gjithashtu aktive në ankandin e pikturave të bëra nga fëmijët e Fshatit SOS.

• Në 30 dhjetor 2015 banka dhe stafi i saj ndër-mori një nismë bamirësie në ndihmë të fëmijëve në nevojë të Fshatit të Fëmijëve SOS dhe në ndihmë të një familjeje në fshatin Babicë të qytetit të Vlorës, duke i siguruar kësaj familje ushqime dhe veshmbathje.

#### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Vijoi kontributin në ndihmë të Sektorit të Tretë dhe ndërmarrjeve sociale, e për t’u përmendur këtu është mbështetja për Programin Botëror të Ushqimit; kryerja e pagesave të Asistencës Financiare të Ushqimit, nëpërmjet logjistikës, tavolinave të dedikuara për të ndihmuar organizatën në shpërndarjen e çeqeve personale të ofruara për familjet e prekura nga përmbytjet në vitin 2015, me një buxhet total prej 1 mln dollarë. Pesë degë u caktuan veçanërisht për të lehtësuar këto pagesa, duke punuar pas orarit standard të punës, vetëm për t’i shërbyer këtyre njerëzve.

#### PROCREDIT BANK

Sponsorizoi zhvillimin e agrobiznesit nëpërmjet Fondit European të Investimit, të ofruar nga Bashkimi European. Qëllimi i këtij fondi është inkurajimi i kreditimit të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme (SME), që kanë nevojë për investime, nëpërmjet mbështetjes financiare të Bashkimit European. Vlera totale e përdorur për veprimtarinë e agrobiznesit, kryesisht në përpunim dhe në prodhim ishte 2.4 milione euro. Procredit Bank mundësoi pjesëmarrjen e 5 (pesë) kompanive në Panairin Ndërkombëtar të Novi Sad-it, më qëllim zhvillimin e marrëdhënieve të reja të biznesit brenda rajonit. Gjithashtu, u organizua në Tiranë një takim “Business to Business” (B2B) me NMV-të serbe.



## OBJEKTIVI #3 – Sigurimi i jetës së shëndetshme

### Nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe <sup>1</sup>

- > Deri në vitin 2030, të reduktohet raporti global i vdekshmërisë së nënave, në më pak se 70 për 100,000 të lindur gjallë.
- > T'i jepet fund epidemive të AIDS-it, tuberkulozit, malaries dhe sëmundjeve tropikale dhe të luftohet hepatiti, sëmundjet nga uji dhe sëmundjet e tjera ngjitëse.
- > Të forcohet parandalimi dhe trajtimi ndaj abuzimit të substancave, duke përfshirë abuzimin me drogën narkotike dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit.



Banca Popolare di Sondrio u ofron klientëve të saj mundësinë e hapjes së një llogarie solidariteti. Përveç interesit të paguar për mbajtësit të llogarisë, banka paguan 0.5% të gjendjes mesatare vjetor në favor të një prej pesë fondeve të bamirësisë, përfshirë UNICEF, sipas zgjedhjes së mbajtësit të llogarisë.

**Burimi: UN Global Compact & Business për vitin 2030**

### Projekte - Përfshirje Publike

#### ALPHA BANK ALBANIA

I dhuroi maternitetit “Mbretëresha Geraldinë” (në bashkëpunim me Fondacionin “Nëna dhe Fëmija”) një aparaturë ekografie me rreze-x, si dhe pajisje mamografie në kuadër të luftës kundër kancerit të gjirit.

#### CREDINS BANK

Mbështeti 13 spitale dhe qendra shëndetësore në të gjithë vendin dhe mori pjesë në organizimin e fushatës së ndërgjegjësimit të “Maratonës së Jetës” dhe fushatave të ndërgjegjësimit në mbështetje të personave me sindromën Down.

#### RAIFFEISEN BANK

- Sponsorizoi krijimin e dhomës Psikomotorike pranë Shërbimit Psikosocial dhe Qendrës së Trajtitimit (TISS).
- Sponsorizoi rehabilitimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve të Ushtarakëve, të cilët vuajnë nga çrregullime të spektrit të autizmit.
- Sponsorizoi rehabilitimin e zonës së Spitalit “Petro Nako” në Sarandë, me qëllim krijimin e kushteve më të mira për pacientët dhe uniformat e reja të stafit të Spitalit të Ersekës.

#### VENETO BANKA

Së bashku me Shoqatën Humanitare të Viçencas “Energia e Sorrisi”, dhuroi një kabinet dentar për Spitalin e Himarës.

1. Përmbljedhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 3. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



*Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshë*

Kontributi i Sistemit Bankar gjatë vitit:  
mbi 188,000 euro.

## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### ALPHA BANK ALBANIA

- Në Ditën Ndërkombëtare të Grave, banka filloi një fushatë ndërgjegjësimiti, me temë: “Jemi të gjithë luftëtarë kundër kancerit të gjirit!”
- Punonjësit e bankës dhe familjet e tyre morën pjesë në maratonën: “Vrapo për Autizmin”, të organizuar në Parkun Kombëtar të Liqenit të Tiranës, në kuadër të Ditës së Vullnetarizmit të Alpha Bank Albania.

### BKT

Sponsorizoi konferencën e organizuar nga Instituti i Shëndetit Publik në Gjirokastrë. Kjo veprimtari kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në përmirësimin e shëndetit publik në rajon.

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Mbi 150 punonjës dhuruan nga pagat e tyre mujore për organizatën “Sue Ryder Albania”, e cila trajton pacientët me kancer në fazën terminale; dhe qendrën multi-funksionale: “Fluturo për Jetën”, që trajton fëmijët me autizëm.

### TIRANA BANK

Iu bashkua nismës së YWCA Albania, duke mbështetur fushatat ndërgjegjësuese për kancerin e gjirit.



Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, **dhurimi i gjakut** ka qenë një fushë kyçe, ku të gjitha bankat kanë qenë shumë aktive, e ku punonjësit kanë treguar anën e tyre humanitare, nëpërmjet pjesëmarrjes së gjerë. Ky akt humanitar kryhet për të ndihmuar njerëzit në nevojë, veçanërisht fëmijët të cilët vuajnë nga sëmundja e talasemisë dhe leuçemisë.



ALPHA BANK



INTESA SANPAOLO BANK  
Albania



NBG Bank



Raiffeisen  
BANK



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK  
rëndësi kanë vlerat



Fibank  
First Investment Bank



ProCredit Bank



TIRANA  
BANK

## OJEKTIVI #4 – Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë

### Nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës <sup>1</sup>

- > Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe atë dytësor pa pagesë, në kushte të barabarta dhe me cilësi, çfarë do të çojë drejt rezultateve të përshtatshme dhe efektive të të mësuarit.
- > Të sigurohet mundësi e barabartë për të gjitha gratë dhe burrat për arsim teknik, profesional dhe terciar, duke përfshirë edhe atë universitar, të përbalueshëm dhe cilësor.
- > Të rritet ndjeshëm numri i të rinjve dhe të rriturve që kanë aftësitë e duhura, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.

### Projekte - Përfshirje Publike

#### BKT

Në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP), të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, mbështeti, për të pestin vit radhazi, përmbushjen e studimeve bachelor të studentëve të regjistruar në këtë Universitet. Në vitin 2015, u punësuan nga BKT, 13 studentë të diplomuar.

#### CREDINS BANK

Mbështeti 6 projekte të shkollave fillore, universiteteve dhe organizatave të shoqërisë civile.

#### NBG BANK ALBANIA

Dhuroi paketa të plota materialeve shkollore për 150 fëmijë në nevojë në Vaqarr, Tiranë.

#### PROCREDIT BANK

- Vijoi programin “Bankierët e Rinj”, një program trajnimi i plotë zhvillimi për të sapodiplomuarit nga fusha të ndryshme.
- Mbështeti botimin e një libri me temat e të gjithë studentëve të paraqitura në konferencën e studentëve, të organizuar nga Fakulteti Ekonomik i UT-së, që u mbajt në Budva, Mali i Zi.

#### RAIFFEISEN BANK

- Mbështeti nismën e Policisë së Shtetit për të trajnuar të rinjtë e përzgjedhur, nëpërmjet një konkursi për punësimin në zyrat për shërbimin e qytetarëve dhe operatorëve 129.
- Mbështeti Drejtorinë Arsimore në Vlorë, Shkodër dhe Fier në veprimtaritë e organizuara me rastin e Ditës së Diplomimit, ku u vlerësuan edhe studentët më të mirë të qytetit.
- Mbështeti Drejtorinë Arsimore në Tiranë, Kavajë, Krujë dhe Lezhë me blerjen e pajisjeve të ndryshme dhe Drejtorinë Arsimore Shkodër, Kuçovë, Berat, Gramsh, Kurbin, Gjirokastër për organizimin e veprimtarive në Ditën e Mësuesit.

#### UNION BANK

Mbështeti konferencën kombëtare për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave.

#### VENETO BANKA

Mbështeti studentët e institutit të kulinarisë “Neranxi” dhe studentët e kursit “Liderët Dental” të një qendre profesionale dentare. Përtej mbështetjes financiare të instituteve profesionale, banka gjithashtu ka ofruar mundësi financimi të favorshme, në ndihmë të studentëve që ndjekin dhe mbarojnë studimet e tyre në këto shkolla, si dhe fillimin e bizneseve, pas diplomimit nga këto institute profesionale.

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 4. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>



*Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë jetës për të gjithë*

Kontributi i sistemit bankar gjatë vitit: mbi 67,000 euro, si dhe rreth 140 orë pune të dedikuara në mësimdhënie vullnetare.

## **Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat** **Angazhimi i Stafit**

### **ALPHA BANK ALBANIA**

Mbështeti Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në organizimin e konkursit: “Shkolla si një qendër komuniteti”. Banka mbështeti idenë fituese të shkollës së Fierit, duke rinovuar krejtësisht laboratorin e informatikës.

### **BKT**

- Mbështeti financiarisht veprimtarinë artistike dhe sportive, të organizuar me rastin e mbylljes së vitit akademik, nga Drejtoria Rajonale Arsimore në Tiranë. Kjo veprimtari organizohet çdo vit dhe ka për qëllim të kënaqë fëmijët nëpërmjet veprimtarive argëtuese dhe sportive.
- Mbështeti financiarisht Institutin e Studentëve të Verbër, për rehabilitimin e fushave të sportit të institutit dhe Universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë, me qëllim organizimin e veprimtarive të ndryshme kulturore dhe akademike.
- Mbështeti financiarisht Akademinë e Forcave të Armatosura, për publikimin e disa librave mësimorë.

### **INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA**

- Shumë nga punonjësit kaluan kohë dhe mblodhën materiale didaktike për fëmijët e komuniteti Rom që hynë për herë të parë në kopësht.
- Në bashkëpunim me Junior Achievement Shqipëri organizoi thirrjen për “udhëheqje vullnetare”, që u drejtua të gjithë punonjësve me aftësi mesimdhënëse dhe të të folurit. Kësaj thirrjeje u përgjigjën 16 punonjës, duke ofruar një herë në javë njohuritë e tyre në shkollat e mesme, si të pranishëm çdo javë, me 1 orë mësimi në klasa.
- Drejtori i Përgjithshëm mbajti një leksion special: “Mësimet e nxjerra nga kriza, sfidat për sistemin bankar” në Universitetin e Tiranës. Drejtuesja e Marrëdhënieve me Publikun, Marketingut dhe Komunikimit mbajti leksione në Fakultetin e Gazetarisë të UT-së dhe UET-së.



### **PROCREDIT BANK**

Përfaqësuesit e Njesisë së Mjedisit, së bashku me Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC) dhe GIZ - EDEP, morën pjesë në një veprimtari me 150 studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Studentët u ndihmuan për të identifikuar mundësitë e tregut të “gjelbër”. Tre studentëve të parë që sollën idetë më inovative u dha mundësia të ndjekin programin e praktikës në ProCredit Bank.

### **VENETO BANKA**

Mbështeti Kongresin e Dentistëve të Shqipërisë dhe Rajonalë, një veprimtari ndërkombëtare, e cila u mbajt në Tiranë.

### **UBA BANK**

Kontribuoi duke ofruar një leksion për Institutin Kanadez të Teknologjisë, CIT, në Shqipëri.

## **Biznesi Bazë - Produkte dhe Shërbime**

### **INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA**

Krijoi një produkt të posaçëm për studentët: “EDU - Kredi”. Kjo është një mundësi financimi, e projektuar rishtazi për të rinjtë, me synim mbulimin e shpenzimeve arsimore gjatë studimeve të tyre.

## OBJEKTIVI #5 – Arritja e barazisë gjinore

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave. Sistemi bankar kontriboi gjatë vitit: mbi 6,500 euro.

### Fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave <sup>1</sup>

- > T'i jepet fund të gjitha formave të diskriminimit kundër të gjitha grave dhe vajzave kudo.
- > Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave, si në sferën publike ashtu edhe në atë private, duke përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual, apo të llojeve të tjera. Të gjitha praktikatat e dëmshme, të tilla si: martesat e fëmijëve, në moshë të hershme dhe të detyruar, si dhe gjymtime të gjentaleve femërore.
- > Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe mundësi të barabarta, për të drejtuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, në jetën politike, ekonomike dhe publike.
- > Të sigurohen mundësitë universale për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe për të drejtat riprodhuese, siç është rënë dakord në përputhje me Programin e Veprimit të ICPD dhe Platformën e Pekinit për Veprim si dhe dokumentet përfundimtare të konferencave.

### Projekte - Përfshirje Publike

#### CREDINS BANK

Gratë mbajnë/drejtojnë shumë nga pozicionet kyçe në Bankën Credins. Banka, gjithashtu, promovon parimet e biznesit dhe ka sponsorizuar veprimtari sociale që promovojnë rolin e grave.

#### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Aktualisht 70 % e stafit janë femra dhe mbi 50% e menaxherëve të lartë janë femra.

#### RAIFFEISEN BANK

Pjesa më e madhe e stafit të bankës janë femra, rreth 77%, krahasuar me 23%, që janë meshkuj. Gjithashtu, rreth 70% e menaxherëve janë femra.



1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 5. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>

# OBJEKTIVI #6 – Sigurimi i ujit të pijshëm

Sistemi bankar kontribuoi gjatë vitit: mbi 10,000 euro.



## Sigurimi i disponueshmerise dhe administrimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë <sup>1</sup>

> Deri në vitin 2030, të realizohet akses universal dhe i barabartë për ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë. Të rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet marrje e qëndrueshme e ujit dhe furnizimi me ujë të pijshëm, të adresohet mungesa e ujit dhe të zvogëlohet ndjeshëm numri i njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit. Të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, duke përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin ndërkufitar. Të mbrohen dhe restaurohen ekosistemet që kanë të bëjnë me ujin, duke përfshirë edhe malet, pyjet, ujëmbledhësat, lumenjtë, ujëmbajtësit dhe liqenet.

## Projekte - Përfshirje Publike

### BKT

Mbështeti Drejtorinë e Ujësjellësit në qytetin e Peqinit. Qëllimi i këtij projekti ishte krijimi i kushteve më të mira sociale të jetesës për qytetarët.

### RAIFFEISEN BANK

Mbështeti Drejtorinë e Ujësjellësit në Fier në projektin për rindërtimin e mjediseve të saj, për të përmirësuar funksionimin dhe duke ofruar kushte më të mira për komunitetin.



1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 6. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>

## OBJEKTIVI #7 – Sigurimi i energjisë për të gjithë

**Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë<sup>1</sup>**

- > Deri në vitin 2030, të sigurohet përdorimi universal i shërbimeve të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë. të rritet ndjeshëm pjesa e energjisë së ripërtëritshme në miksin global të energjinë dhe të dyfishohet ritmi global i përmirësimit të efikasitetit të energjisë.



**Şekerbank** krijoi në vitin 2009 produktin EKO kredi; një hua që financohet investimet dhe shpenzimet në eficiencën e energjisë në Turqi. Banka po mbështet rritjen e ndërgjegjësimit rreth eficiencës së energjisë, për të ndihmuar buxhetet familjare dhe stafi i marketingut të saj janë persona të çertifikuar si konsulentë për izolim ndërtesash. Nëpërmejt produktit EKO kredi janë dhënë më shumë se 600 milionë lira turke (200 milionë USD) si financim. Ajo ka krijuar mbi 60,000 konsumatorë individë dhe 7,000 NVM, artizanë dhe fermerë, si kursimtarë të energjisë.

**Burimi : UN Global Compact Business për 2030**

### Projekte - Përfshirje Publike

#### CREDINS BANK

Në vitin 2015 mbështeti Konkursin Kombëtar për Ide të Gjelbërta, i organizuar nga shoqëria civile.







## Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurtë, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë

Nisma të ndërmarra për eficiencën e energjisë dhe ndikimit pozitiv në mjedis.

Mbështetje financiare ndaj veprimtarive sipas këtij objekti: mbi 2,000 euro.

## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK (ICB)

Gjatë vitit 2015 banka, në bashkëpunim me kompaninë e gjelbër të riciklimit, ka matur ndikimin pozitiv në mjedis.

Ndikimi në mjedis i riciklimit të letrave nga ICB paraqitet si më poshtë:

Mbetje letre (kg)	700.0
Numri i pemëve të kursyera	13.0
Kilovatë të kursyer të energjisë	2,870.0
Fuçi të kursyera me karburant	6.3
Kg e ajrit të ndotur të shmangur	19.0
Metra kub uji të kursyer	25.6
Metra kub të hapësirës depozituese të kursyer	2.3

Përpunimi bazuar në të dhënat e Agjencisë Amerikane për Mbrojtjen e Mjedisit

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Në kuadër të "Reduktimit të Ndikimeve të Drejtpërdrejta në Mjedis" nismat kryesore të ndërmarra për kursimin e energjisë ishin: Konsumi i energjisë: 7-10 herë më pak; rindërtimi i selisë qendrore, rreth 30% më pak nga konsumi aktual; Një total prej 796.72 kg letër u kursue plotësisht në vitin 2015.

- Degët e reja të pozicionuara dhe të rikonceptuara te Blvd. Bajram Curri, Rr. e Elbasanit dhe Dega Korçë janë të pajisura me ndriçim LED dhe kondicionim me parametra efikas të energjisë (inverter, VRF). Ndriçimi i reklamave është me drita LED (7-10 herë më pak konsum).

- Gjatë vitit 2015 u vijua me zëvendësimin e printerave individuale me makina multifunksionale të qëndërzuar, në të gjitha degët.

- Projekti "Rinovimi i Zyrave Qendrore" filloi në vitin 2014 dhe mundësoi futjen e dritës së drejtpërdrejt natyrore në të gjitha hapësirat e punës si dhe uli ndjeshëm konsumin e energjisë, për shkak të ndricimit të ri LED dhe sistemeve të reja të kondicionimit dhe gjenerimit.

- Ndikimi i kursimit të energjisë nga veprimtaria e biznesit, vlerësohet të jetë rreth 30% e konsumit aktual të energjisë.

- Me zbatimin e projektit të delegimit të shërbimit të printimit për zyrat qendrore dhe në të gjitha degët gjatë 2015-ës, u përmbushën objektivat për të ulur përdorimin e letrës dhe të sasisë së CO<sub>2</sub> në mjediset e punës, duke eliminuar printerat dhe skanerat me kuti boje dhe e i zëvendësuar ato me MFM qendrore (Multi-Functional Machines).

- Pakësimi i letrës me kokë për urdhërhirimet e depozitimeve dhe tërheqjes së fondeve, nëpërmjet përditësimit të Sistemit Bazë të Bankës, Flexcube. Në të gjithë bankën u kursye, gjatë vitit 2015, një total prej 796.72 kg letër.

### PROCREDIT BANK

Jetësoi konceptin e Sistemit të Administrimit të Mjedisit në Shqipëri. Si pasojë e masave të ndërmarra, banka e uli në përgjithësi konsumin, krahasuar me një vit më parë, si vijon:

- Reduktim të konsumit të energjisë elektrike me 10 % (ose afërsisht 234,000 kWh/vit)

- Reduktim të konsumit të letrës me 19% (ose afërsisht 1,850 kg/vit)

- Reduktim të konsumit të ujit me 30% (ose afërsisht 1,340 m<sup>3</sup>/vit)

- Reduktim të konsumit të karburantit të përdorur për transport me 11% (ose afërsisht 5,235 litra/vit).

## Biznesi Bazë

### Produkte dhe Shërbime

#### PROCREDIT BANK

Ka vazhduar të mbështesë investimet "E Gjelbërta", nëpërmjet huas EKO, si për individë ashtu dhe për Biznese. Mbështet investime në eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtëritshme si dhe investimet miqësore me mjedisin, nga ana e biznesit. Në fund të vitit 2015 gjendja e portofolit EKO arriti vlerën e 15.8 milionë euro dhe përbënte 9.1% të totalit të portofolit të bankës.

## OBJEKTIVI #8 – Nxitja e rritjes ekonomike dhe Punës së Denjë

Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë <sup>1</sup>

- > Të mbështetet rritja ekonomike për frymë në përputhje me rrethanat kombëtare, dhe në veçanti arritja e rritjes vjetore të PBB-së prej të paktën 7%, për vendet më pak të zhvilluara.
- > Të arrihen nivele më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit, duke përfshirë përqendrimin në sektorë me vlerë të lartë të shtuar dhe ato me punë intensive.
- > Të nxitën politika të orientuara drejt zhvillimit, të cilat mbështesin veprimtaritë prodhuese, krijimin e vendeve të denja të punës, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe inovacionin, si dhe të inkurajohet formalizimi dhe rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke përfshirë edhe lehtësitë për to në burimet financiare.
- > Deri në vitin 2020, të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme përqindja e të rinjve të papunë, të paarsimuar, apo të patrajnuar.
- > Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të çrënjosur punën e detyruar, t'i jepet fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurohet ndalimi dhe eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë. Deri në vitin 2025, t'i jepet fund punës së fëmijëve në të gjitha format e saj.
- > Të forcohet kapaciteti i institucioneve financiare vendase, për të inkurajuar zgjerimin e lehtësive drejt bankave, sigurimeve dhe shërbimeve financiare për të gjithë.



Në mars të 2014-ës **Fondacioni Citi** lançoi “Rrugët drejt Progresit”, një përpjekje për të rritur gatishmërinë për karrierë për 100,000 të rinj në 10 qytete të mëdha të SHBA-së. Ne bashkëpunuam me një rang të gjerë grupesh interesi, ku përfshiheshin politikë-bërësit urbanë, organizata nga sektori privat dhe udhëheqës të komuniteteve nga i gjithë vendi. Programi identifikon dhe rekruton të rinj premtues, nga familje me të ardhura financiare të ulta, për të marrë pjesë në trajnime për sipërmarrjen, lidërsipin dhe mundësitë për shërbime, marrëdhënie mentorimi dhe punësim veror. Gjatë vitit të parë afërsisht 25,000 të rinj përfituan nga projekti “Rrugët drejt Progresit”.

**Burimi : UN Global Compact Business për 2030**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 8. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



*Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë*

Kontributi i sistemit bankar gjate vitit: mbi 15,000 euro.

## Projekte - Përfshirje Publike

### BKT

Mbështeti Panairin e Punës, të organizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Panairin e Punës dhe Studimit, të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

### CREDINS BANK

Bashkëpunoi me institucione lokale dhe qendrore në Tiranë, Durrës, Vlorë, në kuadër të projekteve për përmirësimin e kushteve të punës, të cilat mundësojnë rritjen ekonomike.

### FIBANK ALBANIA

Është sponsori kryesor i punësimit sezonal të studentëve, të organizuar nga Bashkia e Korçës. Gjatë ceremonisë, u shpërndanë certifikata pjesëmarrje për të gjithë studentët që ishin të pranishëm në këtë veprimtari.

### VENETO BANKA

Investoi në fushat e reja të futbollit të Kompleksit Sportiv në Pezë-Helmës, ku do të stërviten dhe promovohen talentet e reja në futboll.



## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### SOCIETE GENERALE ALBANIA

Kodi i Tiranës është një nismë që ka për qëllim rritjen e interesit të rinisë për sipërmarrje në teknologji. Veprimtaria kishte për qëllim trajnimin e 20 pjesëmarrësve, të cilët u zgjodhën nga 200 aplikantë, të cilët dëshironin të mësonin më shumë rreth programimit të rrjetit. Banka sponsorizoi veprimtarinë e organizuar.

### RAIFFEISEN BANK ALBANIA

Mbështeti krijimin e Qendrës së parë Rinore në Shqipëri, një nismë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për të krijuar qendra rinore në të gjithë vendin.

## Biznesi Bazë Produkte dhe Shërbime

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Përmbushi transaksionin përfundimtar në lidhje me zbatimin e procesit të LEA-s (Kalimin dhe Blerjen e Tokës), për një nga investimet më të rëndësishme në Shqipëri: Projekti TAP (Gazë-sjellësi Trans-Adriatik). Nisur nga fakti se shumë banorë jetojnë në fshatrat që do të preken nga projekti TAP janë në vështirësi financiare, banka përgatiti një paketë me produktet dhe shërbimet bankare bazë, me kushte preferenciale, për t'u aplikuar në këtë kategori klientësh.

## OBJEKTIVI #9 – Ndërtimi i infrastrukturave, nxitja e inovacionit

### Ndërtimi i infrastrukturave të qëndrueshme, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit<sup>1</sup>

- > Të zhvillohet infrastrukturë cilësore, e besueshme, e qëndrueshme dhe ezistente, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e shoqërisë, me fokus në qasje të përbalueshme dhe të barabartë për të gjithë.
- > Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe të tjerave, veçanërisht në vendet në zhvillim, në shërbimet financiare, duke përfshirë huadhënie të përbalueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirët e vlerave dhe në tregje.
- > Deri në vitin 2030, të përmirësohet infrastruktura dhe industritë plotësuese të saj, për t'i bërë ato të qëndrueshme, me efikasitet më të lartë në përdorimin e burimeve si dhe një përdorim më të madh të teknologjive dhe proceseve industriale të pastra dhe miqësore me mjedisin.
- > Të zgjerohet kërkimi shkencor, të përmirësohen mundësitë teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, në veçanti në vendet në zhvillim. Deri në vitin 2030, të inkurajohet inovacioni dhe rritja e ndjeshme e numrit të kërkuesve dhe zhvilluesve për 1 milion banorë, si dhe shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin, publik dhe privat

### Projekte - Përfshirje Publike

#### ALPHA BANK ALBANIA

Në kuadër të nismës “Adopto një çerdhe”, në shtator mori përsipër rinovimin e mjedisve të brendshme të çerdes “Zërat e Jetës”, që ndodhet në Kamëz, Tiranë. Në dhjetor stafi i bankës vizitoi fëmijët e kësaj çerdhe, duke i surprizuar me dhurata.

#### BKT

- Bazuar në objektivat vjetore për përmirësimin e kushteve shëndetësore publike, banka investoi në Spitalin Psikiatrik “Dr. Sadik Dinçi”, Elbasan, për mobilimin e tij. Gjithashtu, Banka dhuroi mobilje zyre dhe pajisje për këtë institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit.
- Dhuroi pajisje zyre për Qendrën Shëndetësore në Gosë.
- Sponsorizoi rikonstruksionin e Drejtorisë Rajonale të Qendrës Shëndetësore dhe Fondit të Sigurimeve në Fier.
- Investoi në përmirësimin e kushteve të punës në Institutin e Shëndetit Publik.
- Dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Qendrës Spitalore Universitare.
- Kontribuoi në blerjen e pajisjeve të zyrës për Drejtorinë e Fondit Rajonal të Sigurimit Shëndetësor, që do të ndihmojnë në përmirësimin e standardeve të mjedisve të institucionit.
- Dhuroi kondicionerë të rinj për Drejtorinë Arsimore në Peqin, për të përmirësuar kushtet e mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë muajve të ftohtë.
- Mbështeti shkollën “Mustafa Qemal Atatürk”, nëpërmjet dhurimit me qëllim e ndërtimit të mjedisve shkollorë që do të përmirësojnë kushtet e mësimin.
- Sponsorizoi Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, për ristrukturimin e zyrave të këtij institucioni, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj klientit.

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 9. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



*Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit*

Kontributi i sistemit bankar gjatë vitit: mbi 235,000 euro.

- Mbështeti Drejtorinë e Burgjeve, Durrës dhe Fushë Krujë, me pajisje zyre.
- Mbështeti ristrukturimin e recepsionit dhe sallën e kolegjiut në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- Dhuroi pajisje zyre për Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore në Sarandë.
- Kontribuoi me pajisje zyre për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e motivimit të punonjësve.
- Mundësoi paisje IT për mjediset e Bashkisë Fier, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.
- Dhuroi paisje zyresh për Drejtorinë e Hekurudhave Durrës, për të përmirësuar shërbimin ndaj komunitetit.

### **CREDINS BANK**

Mbështeti 6 institucione në fushën e edukimit, mbrojtjes dhe shëndetësisë, duke u mundësuar pajisje, sisteme dhe software.

### **NBG BANK ALBANIA**

- Dhuroi pajisje zyre për Drejtorinë e Policisë.
- Sponsorizoi rinovimin e mjedisëve të ë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë.

### **RAIFFEISEN BANK**

- Financoi sallat e pritjes në Komisaritet e Tiranës nr.1, 3, 4 dhe 5.
- Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, përruan projektin e rikonstruksionit të rrugës “Dritan Hoxha”, në të cilën korsi të për biçikleta u financuan nga banka.
- Banka sponsorizoi projektin: “Rehabilitimi i fushave të sportit”, për Forcat Speciale RENEA.

### **VENETO BANKA**

Mbështeti Akademinë e Rendit, duke rregulluar hyrjen kryesore të shkollës, në të cilën pritet të studiojnë rreth 300 studentë.

### **TIRANA BANK**

- Banka ndërtoi një muzeum në mjediset e shkollës “Themistokli Gërmenji” në Korçë me rastin e 50 vjetorit të kësaj shkolle.
- Mbështeti Shkollën Profesionale Pogradec për përmirësimin e mjeteve të punës dhe atyre didaktike. Në këtë mënyrë banka mundësoi materiale të reja didaktike për këta nxënës, në mënyrë që ata të konkurojnë suksesshëm në tregun e punës.
- Mundësoi kompjutera dhe pajisje të tjera të teknologjisë së lartë për Drejtorinë Arsimore Pogradec, në mënyrë që të mbështetet organizimi i punës dhe rritja e eficiencës. Gjithashtu, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore të Lezhës u organizua një festë për maturantët e gjimnazeve, me rezultatet më të larta në maturën shtetërore.

## **Biznesi Bazë**

### **Produkte dhe Shërbime**

#### **PROCREDIT BANK**

Prezantoi një koncept të ri bankingu në tregun shqiptar: Zona 24/7. Këto zona janë të pajisura me pajisje të teknologjisë të lartë, që mundësojnë kryerjen e shumë transaksioneve (tërheqje, depozitime, transferta, etj.) në mënyrë të shpejtë, gjatë dhe përtej orarit zyrtar të punës.

#### **SOCIETE GENERALE ALBANIA**

Banka dhe shoqëria ALEAT bashkëpunuan për rritjen e cilësisë së sigurisë së shërbimeve bankare, nëpërmjet autentikimit të sigurt dixhital dhe nënshkrimit elektronik. Në 14 maj 2015, gjatë “Javës së Inovacionit”, një veprimtari që u organizua në Tiranë nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Banka Societe Generale Albania bëri një prezantim me temë: “Të rejat në Sigurinë Dixhitale dhe Eksperienca e Klientit”.

## OBJEKTIVI #10 – Zvogëlimi i pabarazisë

### Zvogëlimi i pabarazisë brenda vendeve dhe mes tyre <sup>1</sup>

- > Deri në vitin 2030, në mënyrë progresive të arrihet dhe mbështetet rritja e të ardhurave për 40%-shin më të varfër të popullsisë, me një ritëm më të lartë se mesatarja kombëtare.
- > Të fuqizohet dhe promovohet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike e të gjithëve pavarësisht nga mosha, gjinia, paaftësia, raca, etnia, origjina, besimi, gjendja ekonomike, apo statuse të tjera.
- > Të sigurohen mundësi të barabarta dhe të reduktohen pabarazitë në rezultate, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe të promovohen legjislacion, politika dhe veprime të përshtatshme, në këtë drejtim.
- > Të përmirësohet rregullimi dhe monitorimi i tregjeve financiare dhe institucionave ndërkombëtare si dhe të synohet zbatimi më i rreptë i këtyre rregullave. Të lehtësohet migrimi i qetë, i sigurt, i rregullt dhe i përgjegjshëm si dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të planifikuara dhe mirëmenaxhuara të migrimit.



**YES BANK** Platforma shumëkanalëshe lokale e dërgesave të parave YES BANK, e quajtur YES MONEY, një platformë që e vlerësuar me çmim, e ndërtuar sipas kërkesave të klientit, ofron shërbime me kosto të ulët, të sigurta dhe me qasje shumë të lehtë, për dërgesa të parave nga miliona punëtorë migrantë në Indi, të cilët kanë nevojë të transferojnë fonde drejt fshatrave dhe qyteteve të tyre të lindjes.

**Burimi: UN Global Compact**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 10. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



## Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet vendeve

Kontributi i sistemit bankar gjatë vitit : 12,300 euro

### Projekte - Përfshirje Publike

#### ALPHA BANK ALBANIA

Mbështeti qendrën e mikpritjes së viktimave të trafikut të qenieve njerëzore në Tiranë, duke i mundësuar asaj mjetet e nevojshme për ta bërë vendin ku ato jetojnë më të ngrohtë dhe mikpritës, në mënyrë që të ndihen si në shtëpi.

#### BKT

Në bashkëpunim me Yunus Emre, mbështetën konferencën e mbajtur në Hotel Tirana nga Barom Balkan Roma Union.

#### RAIFFEISEN BANK

Mbështeti Fondacionin “Down Syndrome Albania”, në organizimin e veprimtarive të zhvilluara me rastin e 21 marsit, ose “Dita Botërore e Sindromës Down”.

#### UNION BANK

Në bashkëpunim me Qendrën e Zhvillimit Publik në Berat mbështeti organizimin e festave të fundvitit për personat me aftësi të kufizuara.

### Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

#### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Mbështeti nismat për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Banka, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, punësoi dy persona nga kjo kategori.

Në këtë kuadër, departamenti i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, organizoi trajnime duke përfshirë degë të ndryshme të bankës. Trajnimet u zhvilluan në Tiranë dhe u ndoqën nga rreth 100 pjesëmarrës.

U organizuan dhe trajnime me temat: “Modelet e aftësisë së kufizuar dhe pengesat përkatëse” dhe “Korniza ligjore për personat me aftësi të kufizuara dhe etika”.



### Biznesi Bazë Produkte dhe Shërbime

#### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Nëpërmjet marrëveshjes së arritur me Postën Shqiptare, i ofroi gjithë klientëve të saj, përfshirë dhe ata potencialë, mundësinë për të marrë shërbimet e saj, sidomos ato që lidhen me financimet për zhvillim ekonomik të bizneseve të vogla familjare në zonat rurale ose qytetet e vogla, duke bërë të mundur që të paguajnë këstet e huave pranë 300 zyrave postare, në të gjithë vendin. Kjo ka për qëllim shmangien e pabarazive në qasjen drejt produkteve apo shërbimeve të caktuara.

## OBJEKTIVI #11 – Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

**Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të sigurt, solid dhe të qëndrueshëm <sup>1</sup>**

- > Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë strehim i përshtatshëm, i sigurt dhe i përballueshëm dhe shërbime bazë, si dhe të përmirësohen lagjet e të varfërve.
- > Të sigurohen për të gjithë sisteme transporti të sigurt, të përballueshme, të arritshme dhe të qëndrueshme, të përmirësohet siguria rrugore, veçanërisht të zgjerohet transporti publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të atyre në situata të cënueshme, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar dhe atyre të moshuar.
- > Të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore.
- > Të reduktohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i personave të prekur prej tyre dhe kryesisht të ulen humbjet ekonomike në raport me PBB-në, të shkaktuara nga fatkeqësitë, duke përfshirë fatkeqësitë e lidhura me ujën, me fokus mbrojtjen e të varfërve dhe njerëzve në situata të cënueshme.
- > Të sigurohet qasje universale në hapësira publike të sigurt, gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe të gjelbërta, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuar.



**MasterCard** Është partner kryesor i Këshillit të Qyteteve Inteligjente, nje koalicion i industrisë përkatëse për të çuar përpara zhvillimin inteligjent të qytetit dhe inovacionin. Kjo nismë do të pajisë drejtuesit e qytetit me burimet dhe mjetet për të planifikuar, financuar dhe zbatuar më mirë risitë në teknologji.

**Burimi: UN Global Compact & Business for 2030**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 11. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.





*Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, elastik dhe të qëndrueshëm*

Kontributi i sistemit bankar gjatë vitit: 300,000 euro

## Projekte - Përfshirje Publike

### ALPHA BANK ALBANIA

Financoi krijimin e mjediseve të përshtatshme të pushimit, në një nga lagjet e qytetit të Lushnjes. Në zonë u mbollën pemë dhe u vendosën kosha për mbeturina.

### BKT

- Bashkëpunoi me Bashkinë Tiranë për krijimin e një parku në qendër të qytetit, me qëllim shtimin e hapësirave të gjebërta dhe mjediseve publike për qytetarët.
- Sponsorizoi Drejtorinë e Rrugëve Rurale në Vlorë, me qëllim përmirësimin e kushteve mjedisore të komunitetit.
- Sponsorizimi për Bashkinë Kavajë konsistoi në blerjen e një kamioni për mbeturinat për kompaninë përkatëse të qytetit.
- Nëpërmjet donacionit për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave mbështeti realizimin e një projekti, që përfshin ndërtimin me kosto të ulët dhe efikase të shtëpive për qytetarët e Korçës.

### CREDINS BANK

Mbështeti 21 institucione dhe organizata, përfshirë këtu gjashtë bashki, dy universitete, institucione qendrore të artit dhe kulturës, si: Teatri dhe Qendra Kulturore për Fëmijë si dhe organizata të shoqërisë civile.

### RAIFFEISEN BANK

- Mbështeti një projekt të Bashkisë Lushnjë për mbjelljen e pemëve dhe rehabilitimin e përroit të qytetit.
- Mbështeti projektin e Bashkisë Korçë për ndriçimin e bulevardit kryesor të qytetit dhe ndërtimin e mjediseve sportive në shkollën "18 Tetori" në Lushnjë, një nismë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me bashkinë e qytetit.

### TIRANA BANK

Iu përgjigj thirrjes së Bashkisë Shijak për pastrimin e zonave publike të kësaj bashkie.



## OBJEKTIVI #12 – Sigurimi i Konsumit dhe Prodhimit të qëndrueshëm

### Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit<sup>1</sup>

- > Të zbatohen programe 10-vjeçare për konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, ku të gjitha vendet të ndërmarrin veprime, nën rolin udhëheqës të vendeve të zhvilluara, duke marrë parasysh zhvillimin dhe aftësitë e vendeve në zhvillim.
- > Të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe shfrytëzimi efikas i burimeve natyrore.
- > Të përgjysmohet shpërdorimi global i ushqimit për frymë në nivelet e shitjeve me pakicë dhe të zvogëlohen humbjet e ushqimit përgjatë prodhimit dhe furnizimit zinxhir.
- > Të reduktohet ndjeshëm prodhimi i mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit, dhe ripërdorimit. Të inkurajohen kompanitë, veçanërisht kompanitë e mëdha dhe kompanitë transkombëtare, të zbatojnë praktika të qëndrueshme dhe të integrojnë informacion mbi qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.
- > Nga viti 2030 të sigurohet që njerëzit kudo ku ndodhen të kenë informacionin dhe ndërgjegjësimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrat e jetesës, në harmoni me natyrën.



Në vitin 2010 **Daegu Bank**, filial kryesor i Grupit Financiar DGB, hapi në Kore një degë të bazuar në internet dhe miqësore për mjedisin në Kore. Dega e tij ofron vetëm produkte financiare të gjelbërta, që mbulojnë depozitat, huat, financime dhe karta krediti, si dhe të dhuron një përqindje të caktuar të fitimit për të mbështetur veprimtaritë që synojnë ruajtjen e mjedisit në rajon.

**Burimi: UN Global Compact  
Business for 2030**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 12. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.




*Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit*

Kontributi i sistemit bankar gjate vitit: 24,000 euro & Mbi 10,000 persona u përfshinë në fushatën sensibilizuese.

## Projekte - Përfshirje Publike

### PROCREDIT BANK

- Prodhoi 600,000 canta, prej të cilave 30,000 u janë dhuruar rrjeteve të supermarketeve, librarive, shkollave, bizneseve, institucioneve publike dhe atyre private. Vlen të theksohet se çantat janë 100% pambuk organik, duke dëshmuar dhe me tej qasjen e përgjegjshme të bankës.
- Investoi në pajisje që shërbejnë për riciklimin e letrave, të cilat janë vendosur në të gjitha degët e bankës.



## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Dita e Mjedisit (WED), dita më e festuar globalisht për veprim pozitiv mjedisor, themeluar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1972, jep një perspektivë njerëzore për çështjet e mjedisit, fuqizon njerëzit të bëhen agjentë aktivë të zhvillimit të qëndrueshëm. Festimet globale për vitin 2015 u organizuan në Ekspozitën e famshme Universale, "Expo Milano 2015" (01.05.2015-31.10.2015), ku Grupi Intesa Sanpaolo ishte partner zyrtar. Gjatë dy javëve banka organizoi një fushate komunikimi të brendshëm dhe të jashtëm dhe fushatë ndërgjegjësimi për të festuar Ditën e Mjedisit. Mbi 10,000 persona u përfshinë në fushatën e ndërgjegjësimi.



## OBJEKTIVI #13 – Lufta ndaj ndryshimeve klimatike

### Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre<sup>1</sup>

- > Të forcohet kapaciteti ripërtëritës dhe përshtatës ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Të integrohen masat ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe plane kombëtare. Të përmirësohet edukimi, ndërgjegjësimi dhe kapaciteti njerëzor dhe institucional për minimizimin, përshtatjen, zvogëlimin e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm të ndryshimeve klimatike.



**HSBC** është një prej institucioneve financiare që po luan një rol të rëndësishëm në formësimin e zhvillimit të shpejtë të tregut të obligacioneve të gjelbërta. Gjithashtu, për më shumë se 10 vjet, HSBC ka punuar me klientët e saj të biznesit për t'i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të menaxhojnë ndikimin e tyre mjedisor dhe social, me fokus në sektorë dhe tema të caktuara. HSBC vlerëson dhe mbështet klientët, duke përdorur politikat e saj, që i rishikon dhe i përpunon rregullisht.

**Burimi: UN Global Compact**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 13. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



## Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij

Sistemi bankar ka kontribuar gjatë vitit: mbi 17,000 euro.

## Avokati Publike dhe Dialog mbi Politikat Angazhimi i Stafit

### PROCREDIT BANK

- Vizita në shtëpizën ekologjike “Eden”, që ofron edukim praktik dhe mjedisor, teatër dhe lojëra në mjedise të hapura si dhe veprimtari të tjera, të cilat inkurajojnë interesin për mjedisin.
- Ndërmori masa për eficiencën e energjisë në degët dhe selinë qendrore. Gjithashtu, këshilluesit e biznesit përdorin makina hibride Eko, kur vizitojnë klientët.
- Fushatë pastrimi nga vet stafi në tre zona turistike, në fillim të muajit qershor 2015 (Velipojë, Vlorë dhe Korçë).

### RAIFFEISEN BANK

- Për më shumë se 4 vjet banka ka mbështetur projektin “Biçikleta është juaja” nga Ecovolis, që lidhet me rritjen e ndergjegjesimit të qytetarët dhe komunitetin e Tiranës për të përdorur biçikletë për nevojat e përditshme, duke ndihmuar në lehtësimin e trafikut dhe për të reduktuar emetimet e karbonit.
- “Eco Fashion Show” është një tjetër projekt eko që banka mbështet që nga viti 2012. Qëllimi është të rrisë ndergjegjesimin dhe të frymëzojë krijimtarinë eko, duke përfshirë fëmijë, artistë, sipërmarrës të shkollës në një pasarelë mode me veshje krijuese të bëra vullnetarisht.
- Mbështeti “Jeto Eko, Festo Eko”, një veprimtari e organizua me rastin e Ditës së Verës.

## Biznesi Bazë Produkte dhe Shërbime

### PROCREDIT BANK

Banka e parë në Shqipëri, e cila në vitin 2009 promovoi eficiencën e energjisë, nëpërmjet huas Eko. Ky produkt ofrohet për të gjithë klientët (si biznes ashtu dhe individë) për eficiencë në energji, investimet në energji të ripërtëritshme dhe investime miqësore me mjedisin.



## OBJEKTIVI #17 – Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim

### Rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm<sup>1</sup>

**Financë** - Fuqizimi i mobilizimit të burimeve vendase, duke përfshirë mbështetjen ndërkombëtare për vendet në zhvillim, për të përmirësuar kapacitetet vendase për mbledhjen e taksave dhe të të ardhurave.

**Teknologji** - Nxitja e zhvillimit, transferimit, shpërndarjes dhe përhapjes së teknologjive ekologjikisht të shëndosha në vendet në zhvillim me kushte të favorshme, duke përfshirë kushte lehtësuese dhe preferenciale, ashtu siç bien dakord bashkërisht.

**Ndërtimi i kapaciteteve** - Rritja e mbështetjes ndërkombëtare për zbatimin efektiv dhe të targetuar të ndërtimit të kapaciteteve në vendet në zhvillim, për të mbështetur planet kombëtare për zbatimin e të gjitha qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë bashkëpunimin Veri – Jug, Jug – Jug dhe atë trekëndor.

**Tregtia** - Nxitja e një sistemi tregtimi universal shumëpalësh, të bazuar në rregulla, të hapur, jodiskriminues dhe të drejtë nën kujdesin e Organizatës Botërore të Tregtisë, duke përfshirë gjithashtu konkluzionet e negociatave, sipas Agjendës së Zhvillimit të Dohas.



Disa institucione financiare janë angazhuar në mënyrë konstruktive në procese në rrafsh ndërkombëtar, ku bëjnë pjesë edhe katër negocimet ndërkombëtare të realizuara në vitin 2015 (Konferenca Botërore për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë, Samiti për Miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike), si dhe përgatitja e Takimit Humanitar Botëror për vitin 2016.

**Burimi: UN Global Compact**

1. Përmbledhja e mësipërme përfshin vetëm një pjesë të synimeve të Objektivit 17. Për më shumë detaje vizitoni faqen <https://sustainabledevelopment.un.org/>.



*Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm*

Kontributi i industrisë bankare gjatë vitit:  
mbi 82,000 euro

## Projekte - Përfshirje Publike

### ALPHA BANK ALBANIA

Sponsorizoi krijimin dhe printimin e katalogut “Uji në arte dhe zejтари në rajonin e Beratit”. Kjo ishte një hulumtim i rëndësishëm shumëvjeçar, pasi shumica e materialeve të kësaj periudhe (shek. 4 para erës sonë – shek. 19 pas erës sonë) janë shkatërruar nga zjarri. Promovimi i librit u bë në Universitetin e New York-ut në Tiranë dhe në muzeun “Onufri” në Berat, ku banka financoi dhe vendet ku ishte ekzpozuar katalogu.

### CREDINS BANK

Bashkëpunoi dhe mbështeti me financim dy projekte për përmirësimin e infrastrukturës kompjuterike për institucione të drejtësisë, pjesë e domosdoshme për të pasur institucione të efektshme.

### INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Kontribuoi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, historike, artistike dhe publike, përmes mbështetjes financiare të punimeve të ndërtimit në Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD.al), në katin e parë të Godinës së Kryeministrit.

### TIRANA BANK

- Mbështeti veprimtarinë e veçantë që u organizua në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse “Ringjallja e Krishtit”, Ambasada e Greqisë në Shqipëri prezantoi në 26 janar Indeksën e Marrëdhënieve të Biznesit Grek - Shqipëri, me qëllim të regjistrimit në mënyrë sistematike të sektorit grek të biznesit që operon në Shqipëri.
- AmCham festoi 15 vjetorin në Shqipëri dhe Tirana Bank ishte pjesë e kësaj veprimtarie, jo vetëm si anëtare e dhomës, por edhe si një institucion që përfaqëson vlerat e kësaj organizate, për ndërtimin e një klime më të mirë të biznesit, për nxitjen e ekonomisë shqiptare si dhe të parimeve dhe standardeve të biznesit.

### RAIFFEISEN BANK

Çdo vit mbështet Ambasadën e Austrisë në Tiranë në të gjitha aktivitetet kulturore që organizon në Tiranë dhe në qytetet e tjera për festimin e Ditës Kombëtare të Austrisë.

### 15 vjetori i FIAA-s

Në ceremoninë e fillimit të vitit, ku morën pjesë mbi 150 investues të huaj që janë në Shqipëri, u vendos agjenda për progres ekonomik. FIBank ishte sponsori kryesor i veprimtarisë, por edhe Banka Intesa Sanpaolo dhe Tirana Bank e mbështetën atë.





# SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS

**1** PA VARFËRI

**2** ZERO URI

**3** SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

**4** ARSIM CILËSOR

**5** BARAZI GJINORE

**6** UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

**7** ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR

**8** PUNË DINJITOZE DHE RRIJJE EKONOMIKE

**9** INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË

**10** ZVOGËLIM I PABARAZIVE

**11** QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

**12** KONSUM DHE PRODHIM I PËRQJEGJSHËM

**13** VEPRIM PËR KLIMËN

**14** JETA NËN UJË

**15** JETA NË STERE

**16** PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA

**17** PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

**BJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**



# Veprimtari të Veçanta

## Ballo Presidenciale e fundvitit

Kjo veprimtari u organizua nën kujdesin e Sh.T. Presidentit Bujar Nishani dhe Zonjës së Parë zj. Odeta Nishani, me qëllim grumbullimin e fondeve për mbështetjen e fëmijëve me Sindromën Down.



## Lëvizja “Solidariteti Shqiptar” për mbështetjen e zonave të përmbytura

AAB dhe bankat anëtare të saj, në vijim të situatës së përmbytjeve dhe dëmeve të shkaktuara në shumë familje në zonën jugore të vendit, ofruan mbështetjen e tyre, veçanërisht te personat me më shumë nevojë. AAB dhuroi 6 milionë lekë, për të ndihmuar fermerët dhe familjet e prekura nga fatkeqësia natyrore, pa përmendur këtu nismat individuale të bankave, të cilat treguan solidaritet me familjet e prekura dhe autoritetet e përfshira në përmirësimin e situatës.



## Art, Sport & Kulturë

### ALPHA BANK ALBANIA

- “Fondacioni i Kitarave në Shqipëri” dhe Universiteti i Arteve në Tiranë organizuan edicionin e 3-të të Festivalit Ndërkombëtar të Kitarës. Alpha Bank Albania ishte sponsor i përgjithshëm në këtë veprimtari.
- Sponsorizoi Festivalin Folklorik Kombëtar. Në Festival morën pjesë 1,204 përfaqësues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

### BKT

- Mbështeti financiarisht aktivitete të ndryshme kulturore dhe takime (mbledhje pune) të Qendrës së Turizmit, Kulturës dhe Sporteve të Bashkisë Vlorë, me personalitete nga rajoni.
- Mbështeti Festivalin e Këngëve dhe Valleve Popullore të Fëmijëve, të organizuar në Krujë nga Qendra Kulturore e Fëmijëve, Fushë Krujë.
- Në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në Ankara, BKT mbështeti veprimtarinë e organizuar në Turqi në datën 28 nëntor, me rastin e Ditës Kombëtare të Pavarësisë.

### FIBANK ALBANIA

Sponsori zyrtar i Birra Fest 2015 në Korçë, nga 12 - 16 gusht. Birra Fest është ngjarja më e madhe e këtij lloji në Shqipëri. Brenda 5 ditëve, mbi 100,000 njerëz e vizituan këtë festival.

### NBG BANK ALBANIA

Sponsori i përgjithshëm i shfaqjes së dramës: “Kush e solli Doruntinën”, bazuar në romanin e famshëm të Ismail Kadaresë.

### RAIFFEISEN BANK

- Sponsor i përgjithshëm i veprimtarisë sociale: “Ndiq ëndrrën tënde”, të organizuar nga Shoqata e Gjymnastëve Artistikë Aerobikë. Veprimtaria u organizua me rastin e ditës Ndërkombëtare të Jetimëve, në 20 maj, dhe u ndoq nga më shumë se 500 fëmijë të moshës 5 – 18 vjeç, që vinin nga shkolla 9-vjeçare dhe të mesme nga Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Lushnja, Kosova, etj.
- Partner i Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, duke mbështetur të gjitha veprimtaritë e organizuara gjatë vitit 2015, si dhe sponsor i përgjithshëm i koncertit të përvitshëm: “3 Tenorët”.
- Iu bashkua Ministrisë së Kulturës në projektin për organizimin e “Festivalit Folklorik Kombëtar - Gjirokastra 2015”, për rindërtimin e infrastrukturës në kala, rrugës hyrëse, ndriçimit të brendshëm të kalasë, etj.





Kontributi i industrisë bankare gjatë vitit:  
mbi 170,000 euro.

### **SOCIETE GENERALE ALBANIA**

- Mbështeti çeljen e Sezonit të Verës në Himarë, bregdeti jugor.
- Mbështeti Qendrën Kulturore të Fëmijëve Përmet, e cila në bashkëpunim me shkollën “Suhareka” në Kosovë, organizuan mbrëmjen poetike. E njëjta veprimtari organizua edhe në Kosovë.
- Mbështeti organizimin e Birra Fest në qytetin e Korçës.
- Mbështeti Festivalin Operistik Ndërkombëtar: “Maria Kraja”, që u mbajt në 30 – 31 tetor 2015.
- Mbështeti mbrëmjen e madhe gala të Çmimeve organizuar nga Akademia Kult në hollin e Pallatit të Kongreseve.
- Mbështeti Ekspozitën e 4-t të Artit, të organizuar nga KALO GALLERY.

### **TIRANA BANK**

- Me qëllim të mbështetjes së prodhuesve lokalë për promovimin e produkteve të tyre, edhe për vitin 2015, vazhdoi traditën e saj në mbështetjen e “Mbrëmjes së Verës” organizuar në Pogradec.
- Mbështeti koncertin muzikor klasik “Ndërmendje” dhe veprimtarinë “Shkodra n’fest” organizuar në Shkodër.
- Mbështeti ekspozitën e quajtur: “Fytyrat”, pjesë e Ekspozitës së Arteve të Bukura, KALO GALLERY.

### **UNION BANK**

Union Bank është sponsor i ekipit kombëtar të futbollit.

### **VENETO BANK**

- Sponsor zyrtar i Albania Open 2015.
- Fluturimi i lirë është një sport që po zhvillohet në Shqipëri vitet e fundit. Për të dytin vit radhazi, Banka Veneto mbështeti financiarisht Aeronautikën Shqiptare për kampionatin e organizuar në Llogara dhe Vlorë, me pjesëmarrjen e pilotëve nga gjithë bota.



# Çmime



## ALPHA BANK ALBANIA

U nderua me çmimin Kombëtar të Filantropisë 2015. Veprimtaria, e organizuar nga Partners Albania, u ndoq nga personalitete të shquara nga misionet diplomatike dhe institucionet ndërkombëtare në Shqipëri, OJF, institucione shtetërore, biznese, përfaqësues të mediave, etj.

## BKT

U përzgjedh sërish si “Banka më e mirë në Shqipëri për 2015” nga “The Banker”. Ky është viti i tretë që BKT vlerësohet me tre nga çmimet më të mëdha (The Banker, Euromoney dhe EMEA Finance) në industrinë bankare.

## INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK (ICB)

Rrjeti Shqiptar i Përgjegjshmërisë Sociale (Albanian CSR Network), në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe me UNDP Albania, organizoi për të dytin vit radhazi, dhënien e çmimeve për kompanitë më të mira në fushën e Përgjegjshmërisë Sociale. Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) u zgjedh si fituese për kategorinë e tretë dhe u nderua me çmimin “Iniciativa më e Mirë”.

## FIBANK ALBANIA

Në ceremoninë e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, FIBank Albania u nderua me çmimin “Banka e Vitit 2015” – si banka më e mirë në përmbushjen e standardeve të larta në shërbim të klientëve, duke ofruar produkte sipas nevojave që ata kanë.

## PROCREDIT BANK

Si anëtare prej vitesh e Shoqatës së Investitorëve të Huaj, u nderua me një trofe mirënjohje, gjatë ceremonisë së organizuar për 15 vjetorin e FIAA-s.

## RAIFFEISEN BANK

Në kuadër të 10 vjetorit të përfshirjes në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, qyteti i Gjirokastrës organizoi një seri veprimtarish me komunitetin lokal, biznesin dhe organizatat jofitimpurëse, të fokusuar në ruajtjen e trashëgimisë së qytetit. Në një ceremoni të veçantë, Banka Raiffeisen Shqipëri u nderua me titullin “Mirënjohja e Qytetit”, për kontributin e saj të çmuar në shumë sektorë, të tillë si: shëndetësia, arsimiti dhe kultura.

